



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

06.Nr. 945

Data : 18.07.2025

Në bazë të Ligjit NR.03/L-164 për Financimin e programeve të veçanta dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.23/2010 për procedurat e shpalljes së veçantë të banimit si dhe Vendimit të Kuvendit Komunal me nr.01.Nr. 016-31325 datë 30.05.2025, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale rishpallë këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM PËR BONUS BANIM

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë thirrje publike për Bonus Banim, ku me anë të kësaj thirrje parashihet subvencionimi prej 50% të shumës së përgjithëshme të qerasë për familjet nevojtare, andaj të drejtën e aplikimit e kanë familjet të cilat:

1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale.
2. Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
 - Vlera e bonus banimit do të jetë 50% e shumës së qirasë minimale të banesave në tregun e lirë në territorin e Komunës së Suharekës për vitin 2025.
 - Përfitues nga kjo thirrje do të jenë pesëmbëdhjetë (15) familje, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara në thirrjen publike.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Letërnjoftimi kopje vetëm për aplikuesin;
- Deklarata e bashkësisë familjare;
- Vërtetim që nuk posedon shtëpi banimi;
- Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale për gjendjen ekonomike (për përfituesit e skemës sociale);
- Vërtetim nga mjeku për invaliditet/gjendja shëndetësore për aplikuesin (për personat që vuajn nga sëmundje të ndryshme);
- Vërtetimi mbi vendbanim e përhershëm;
- Përparësi do të kenë nënat vetë ushqyese.

Vërejtje:

- Aplikacionet mund ti merrni në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale tek Parku i qytetit kati tretë;
- Dorëzimi i aplikacioneve bëhet tek zyra numër 1, e gjendjes civile, ato duhet të jenë të mbyllura në zarf dhe të protokolluara;
- Aplikacionet e arritura pas afatit të paraparë dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;
- Thirrja publike për aplikim fillon nga data 18.07.2025 dhe përfundon me datë 18.08.2025;
- Lista e përfitueseve do të publikohet brenda afatit ligjor;
- Aplikantët duhet të jenë banor të përhershëm të Komunës së Suharekës.

Drejtori i DSHMS
Ma.Sc. Besa KUQI

